

25. Gratë e vajzat e torturuara nga dhuna në familje, që ato të gjejnë forca në Zotin dhe të kuptojnë vlerën dhe dinjitetin e tyre si bija të Atit tonë në qiell. (Psalmi 5:11)

26. Njerëzit në Kenia që përballen me varfërinë e mjerë, vetvrasjen midis të rinjve, dhe dhunën duke përshtirë edhe vrasjet e grave e fëmijëve nga burrat e tyre.

27. Nënata dhe baballarët në Poloni të duan, të mbrojnë dhe të kujdesen për fëmijët. Ditë për ditë mediat raportojnë për fëmijë të humbur dhe fëmijë që vriten nga prindërit.

28. Burra dhe gra të dëgjojnë programet “Shpresë për ty” dhe të mësojnë të kenë marrëdhënie të shëndetshme, marrëdhënie dhe familje të perëndishme.

29. Fëmijët në Nepal që janë përdhunuar, abuzuar seksualisht, janë detyruar të kryejnë aborte ose madje edhe të vriten nga të afërmit e tyre. (Psalmi 72:14)

30. Gratë dhe vajzat që janë pre e dhunës në familje për shkak se prindërit apo vëllezërit e tyre përdorin droga apo alkool.

31. Kujdestarët e fëmijëve, të pleqve dhe të personave me aftësi ndryshe të kërkojnë ndihmë para se acarimi i tyre të çojë në fjalë të rënda dhe veprime të dhunshme.

Dëgjoni programin “Shpresë për ty” në:

Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30

Radio Emanuel: 95,7 FM:

të shtunën ora 9:00

Radio Logos: 94,2 FM

të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe 17:00

Perëndia im, shkëmbi në të cilin strehohem, mburoja ime, fuqia e shpëtimit tim, strehimi im i lartë, streha ime. O shpëtimtari im, ti më shpëton nga dhuna! (2 Samuel 22:3)

Shtëpia është supozuar të jetë një vend i sigurt. Por, në çdo kulturë dhe fe, dhuna në familje ka bërë që numër i madh grash të thërrasin për mbrojtje. Fatkeqsisht, thirrjet për ndihmë janë kaq të zakonshme dhe ndikojnë gratë dhe vajzat në çdo stad të jetës. Një në tre gra në mbarë botën kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale në shumicën e rasteve nga partneri i tyre më i afërt. Disa prindër i shesin vajzat e tyre si nuse ose prostituta, ose i detyrojnë ato të kryejnë shtrembërim gjenital. Bijat dhe bashkëshortet janë djegur me acid dhe ujë të nxehtë për shkak se kanë “çnderuar” familjet e tyre. Shumë viktime janë totalisht të varur nga abuzuesit e tyre dhe nuk kanë vend të sigurt ku të shkojnë. Këto vajza dhe gra kanë nevojë për ndihmë por shpesh ndihen të turpëruara dhe u mungon mbështetja nga familjet apo komunitetet e tyre. Iniciativat për të ofruar kujdes shëndetsor dhe Plani global i organizatës botërore të shëndetit janë shumë të rëndësishme në adresimin e këtij problemi mbarëbotëror. Por një përpjekje për të shëruar plotësisht gratë dhe vajzat patjetër duhet të përfshijë Perëndinë. Të përm-bushësh misionin për të sjellë Jezusin tek gratë rreth e rrotull botës dhe përtej brezave, programi “Shpresë për ty” ka shumë episode përkushtuar dhunës në familje dhe abuzimit dhe se si të kërkojë ndihmë. Në program dëgjojmë se Zoti dëgjon thirrjen tuaj dhe Ai mund të sjellë shpresë edhe në situatat më të vështira. Zoti e urren abuzimin verbal, fizik dhe seksual. Ai mund të na lajë dhe të na pastrojë nga efektet e abuzimit dhe të bëjë që të gjejmë jetë në anën tjetër të traumës. Ati ynë është Ai që sjell shërim të brendshëm në shpirtrat tanë, ai që na garanton për vlerën tonë të vërtetë si bijat e tij të dashura. Ati ynë dëshiron që ne të jemi në një vend të sigurt dhe që ne të zbulojmë që Ai është vendi ynë i sigurtë.



Të lutemi kundra dhunës në familje

"Për shkak të shtypjes së të mjerëve dhe të britmës së nevojtarëve, tani do të çohem," thotë Zoti, "dhe do t'i shpëtoj nga ata që u zënë pusi"

– Psalmi 12:5



Programi “Shpresë për ty” transmetohet
në 73 gjuhë.

Kërkesat mujore të lutjes përdoren
në 100 gjuhë.

Dëgjoni kalendarin e lutjes online në:
twr-albania.com

1. Burrat të duan dhe t'i mbrojnë gratë e tyre si një thesar, duke kuptuar që Zoti u ka besuar atyre mbrojtjen dhe kujdesin për familjen e tyre. "Ju, burra, t'i doni gratë tuaja, sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të." (Efesianëve 5:25)

2. Historia e Dr. Peggy Banks për shërimin e brendshëm, që jepet në radio dhe në internet të arrijë gratë në Gjermani që vuajnë nga dhuna. Atje çdo tre ditë vritet një grua nga partneri i saj ose nga ish-partneri.

3. Gratë në Serbi që abuzohen fizikisht, mendërisht dhe seksualisht për shkak se ato shihen gjithnjë në nivel më të ulët në shoqëri, të mos kenë të raportojnë dhunën në familje dhe që do të merren masat e duhura mbështetur në këto raportime.

4. Perëndia t'i largojë zemrat e njerëzve nga dhuna dhe sjelljet e mbrapshta seksuale që janë zbuluar në media në Tajlandë, që shumë besojnë se kontribuojnë në rritjen e dhunës në familje. Lutuni për drejtuesit tajlandezë të kenë urtësi për të adresuar këtë problem.

5. Shërimi fizik, shpirtëror dhe emocional të zërë vend në jetën e grave dhe fëmijëve që janë viktima të dhunës në familje. Lutuni që kisha dhe shërbesa të krishtera të sigurojnë ndihmë dhe shërim. (Psalmi 20:1)

6. Policia dhe ata që janë në pushtet të adresojnë në mënyrën e duhur problemin e dhunës në familje në Irlandën e Veriut. Falemnderit Zotit që kohët e fundit është rritur ndërgjegjësimi dhe më shumë njerëz po e raportojnë dhunën tek autoritetet.

7. 1 në 3 gra bullgare janë viktima të dhunës në familje. Në tre vitet e fundit, vrasjet e grave nga bashkëshortët, partnerët ose të afërmit e ngushtë janë rritur me 50 përqind.

8. Ata që përjetojnë dhunë në familje në shtëpitë e krishtera, ku janë mësuar t'i nënshtrohen një anë-tari abuziv në familje. Lutuni që të krishterët nuk do ta shtrembërojnë Shkrimin për të shfajësuar ose justifikuar sjelljet abuzive.

9. Mbrojtjen dhe shërimin e grave në Groenlandë, ku 62% e grave të rritura kanë përjetuar dhunë në një moment të jetës së tyre. Lutuni që komunitetet do t'i bëjnë përgjegjës abuzuesit për veprimet e tyre. (Psalmi 140:1)

10. Ata 18 000 fëmijë në strehat në Hollandë, shumë prej të cilëve kanë vuajtur dhunë në familje. Lutuni që familjet e krishtera kujdestare të mod-elojnë dashurinë e Zotit dhe t'u dhurojnë një vend të sigurt ku të rriten. (Psalmi 41:2)

11. Abuzuesit të mund të ndryshohen nga mëshira e Zotit. "I pabesi le ta lërë rrugën e tij dhe njeriu i padrejtë mendimet e tij, dhe le të kthehet tek Zoti që të ketë dhembshuri për të, tek Perëndia ynë që fal bujarisht." (Isaia 55:7)

12. Ato 3,491 gra dhe 2,724 fëmijë në Kanada që flenë në strehëza për t'i shpëtuar abuzimit çdo natë. Rreth 300 gra dhe fëmijë kthehen çdo ditë për shkak se strehëzat janë plot.

13. Policia në Francë të ndërhyjë në situatën e dhunës në familje dhe t'i marrë ankesat e grave seriozisht. Mbi 100 gra janë vrarë këtë vit në Francë nga partnerët akutalë apo ish-partnerët. (Ps. 40:11)

14. Pastorët, të ngrenë zërin kundra dhunës, duke i inkurajuar ata që janë të abuzuar të shkojnë tek drejtuesit e kishës për të kërkuar ndihmë dhe siguri. Dhe lutemi që drejtuesit t'i mbajnë përgjegjës abuzuesit në mënyrë që dhuna të ndalojë.

15. Gratë që përjetojnë dhunë në familje në Zvicër të kenë kurajon të ngrihen dhe të mos vuajnë në heshtje turpin. Lutuni për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe që të ketë dialog.

16. Qeveria e re finlandeze t'i drejtojë burimet për të reduktuar dhunën në familje. Lutuni për ata që vuajnë dhunë fizike dhe abuzim emocional në shtëpi që të mund të marrin ndihmë dhe mbështetje.

17. Kisha dhe shërbimet sociale në Shqipëri të mbështesin nënat e vetme që dalin nga qendrat e dhunës. Këto nëna shpesh punojnë orë të gjata duke i lënë fëmijët e tyre vetëm në shtëpi.

18. Drejtuesit e kishave në Vietnam t'u mësojnë burrave t'i respektojnë dhe duan gratë e tyre. Lutuni gjithashtu që burrat dhe gratë do të kuptojnë vlerën e tyre si bij e bija të Perëndisë.

19. Më shumë se 1.8 million gra në Ukrainë që janë të ekspozuara ndaj dhunës në familje, gjë që ka sjellë vdekjen e 600 grave vitin e kaluar. Vetëm 10% e grave kanë shkuar në polici. (2 Sam. 22:3)

20. Gratë që janë larguar nga Korea e Veriut dhe janë martuar me burra në Kinë. Këto gra shpesh nuk e raportojnë dhunën në familje nga frika se mos arrestohen apo kthehen në vendin e tyre.

21. Fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në familje midis prindërve të shërohen nga problemet emocionale, duke përfshirë mosbesimin e të rriturve, fajin, turpin, zemërimin dhe sjelljet agresive. (Psalmi 32:27)

22. Të rritet interesi global i ndërgjegjësimit për sëmundjet emocionale dhe mendore. Lutuni që do të ketë burime dhe kujdes për ata që luftojnë në këto fusha.

23. Qeveria portugeze të hartojë ligje të forta që mbrojnë viktimat nga dhuna në familje. Lutuni që gjyqtarët të jenë të drejtë dhe të mos mbajnë anën e askujt por të zbatojnë ligjin.

24. Gratë e rrahura që mbrojnë abuzuesit e tyre. Lutuni që ata të kuptojnë që kjo pengon abuzuesin nga marrja e ndihmës dhe e aftëson atë të lëndojë të tjerë.